

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E NDËRMJETËSVE
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME

VENDIM

Nr. 10 datë 27/12/2013

PËR
MIRATIMIN E “KODIT TË ETIKËS SË NDËRMJETËSIT”

Në mbështetje të të nenit 7, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar dhe nenit 9, shkronja “a”, të Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve,

VENDOSI :

1. Miratimin e “Kodit të Etikës së Ndërmjetësit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet çdo ndërmjetës që ushtron profesionin e ndërmjetësit dhe është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Ndërmjetësve të respektojë dispozitat e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Kryesia e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve me monitorimin e zbatimit të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Drita Avdyli

Miratuar më datë, 27,12, 2013.

KODI I ETIKËS SË NDËRMJETËSIT

Preambula

Përdorimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e një shumëllojshmërie të gjerë të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve, pritet të rritet gjerësisht dhe ky sistem përbën një pjesë të rëndësishme të Sistemit të Drejtësisë, i cilin synon të rregullojë marrëdhëniet në shoqërinë tonë.

Personat të cilët veprojnë si ndërmjetës, marrin përsipër përgjegjësi serioze si për shoqërinë, ashtu edhe për palët. Në këtë përgjegjësi përfshihen edhe detyrime të rëndësishme të etikës.

Kodi i Etikës, përcakton standardet e përgjithshme të etikës dhe udhëzime për orientimin e ndërmjetësve në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të shumëllojshme që i nënshtrohen procesit të ndërmjetësimit, me qëllimin për të kontribuar në ruajtjen e standardeve të larta dhe rritjen e besimit të palëve në procesin e ndërmjetësimit.

Ndërmjetësit, ndryshe nga gjyqtarët dhe arbitrat, nuk kanë pushtet për të vendosur mbi çështjet që iu paraqiten atyre. Ndërmjetësimi mban gjithmonë në konsideratë marrëveshjen dhe miratimin e palëve në proces.

Ndryshe nga gjyqtarët me kohë të plotë pune, ndërmjetësit janë të angazhuar zakonisht në profesione të tjera, para, gjatë dhe pas kohës që ata shërbejnë si ndërmjetës. Shpeshherë, ndërmjetësit zgjidhen nga e njëjta fushë si ajo që paraqet lloji i konfliktit, në mënyrë që të sjellin njohuritë, eksperiencën dhe aftësitë e posaçme në detyrën e ndërmjetësimit.

Kodi Etik, zbatohet për të gjithë ndërmjetësit e licencuar për të ofruar shërbimin e ndërmjetësimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat kryesore të Kodit të Etikës të ndërmjetësve janë:

- a. Të ofrojë parimet udhërrëfyese për sjelljen e Ndërmjetësve;
- b. Të ofrojë mjetet e mbrojtjes për publikun; dhe
- c. Të promovojë besueshmërinë tek ndërmjetësimi, si një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

KREU I

DISPOZITA PARAPRAKE DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1

Qëllimi i Kodit të Etikës

1. Qëllimi i Kodit të Etikës është të përcaktojë parimet bazë të veprimitarisë së ndërmjetësit për të siguruar zhvillimin e drejtë dhe korrekt të procedurës së ndërmjetësimit sipas vlerave etike dhe normave deontologjike mbi të cilat bazohet veprimtaria e ndërmjetësit.
2. Parimet bazë të Kodit të Etikës janë korrektësia, respekti, transparenca, profesionalizmi, ndershmëria dhe mbrojtja e të gjitha interesave të palëve të përfshira.
3. Funkzioni i Kodi të Etikës është të përcaktojë rregullat dhe normat e sjelljes së ndërmjetësit me qëllim ushtrimin e veprimitarisë së tij në përputhje me ligjin dhe në respekt të plotë të dinjitetit njerëzor dhe misionit të ndërmjetësit .

Neni 2

Misioni i Ndërmjetësit

1. Misioni i ndërmjetësit i shërben miradministrimit të sistemit të drejtësisë dhe përmbushjes së interesave publike, si dhe garanton vijimësinë dhe nxitjen e kulturës së pajtimit.
2. Rregullat e etikës kanë si qëllim të sigurojnë ushtrimin sa më korrekt të misionit të ndërmjetësit.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllim të Kodit të Etikës, “ndërmjetës” është personi i licencuar për të zbatuar një proces ndërmjetësimi, roli i të cilit është të ndërmjetësojë palët në mënyrë të paanshme dhe profesionale, duke u përpjekur që t’i ndihmojë e inkurajojë ato, në arritjen e një marrëveshjeje që e zgjidh mosmarrëveshjen duke i dhënë fund konfliktit mes palëve.
2. Në kuptimin e Kodit të Etikës, “procesi i ndërmjetësimit” është veprimtaria jashtëgjyqësore e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, me të cilën dy ose më shumë palë të synojnë për të arritur një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit mes tyre, pa dhënien e një vendimi dhe me ndihmën e një pale të tretë (“ndërmjetësi”)

për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

3. Me Dhome anëtarësie kuptohet dhoma vendore ku ndërmjetësi është anëtar.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kodi i Etikës zbatohet për të gjithë ndërmjetësit dhe në të gjitha procedurat e ndërmjetësimit në çështjet civile, tregtare, familjare, atyre të punës si dhe ato penale, të parashikuar nga legjislacioni përkatës në fuqi.
2. Subjektet që ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit mund t'i propozojnë Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve kode më të detajuara të etikës, në përshtatje me kontekstin e tyre specifik ose sipas llojeve të shërbimeve të ndërmjetësimit që ato ofrojnë, si dhe për fusha të veçanta të tilla si: ndërmjetësimi familjar ose ato që kanë të bëjnë me konsumatorin.

Neni 5

Detyrimi i zbatimit të rregullave të Kodit të Etikës

1. Dispozitat e Kodit të Etikës janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë ndërmjetësit në të gjitha situatat në ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit.
2. Detyrimet etike për ndërmjetësin zbatohen nga çasti i fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit deri në çastin e heqjes së licencës. Detyrimet etike në një procedurë ndërmjetësimi lindin nga çasti i caktimit të ndërmjetësit dhe qëndrojnë deri pas përfundimit të procesit të ndërmjetësimit.
3. Dispozitat e këtij Kodi janë pjesë e detyrueshme e objektit të trajnimit profesional të ndërmjetësve. Ato kanë për qëllim udhëheqjen e procedurës së ndërmjetësimit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit të ofruar.
4. Zbatimi i rregullave të etikës i shërben përmbushjes së rregullt të misionit të ndërmjetësit në realizimin e interesave dhe të drejtave legjitime të palëve, duke siguruar një proces të ndershëm ndërmjetësimi.
5. Për ndërmjetësin që shkel parimet dhe rregullat e parashikuara në këtë Kod, merren masa disiplinore. Shkeljet disiplinore nuk paragjykojnë dhe janë të pavarura nga shkeljet e natyrës civile apo penale, që mund të jenë kryer nga ana e ndërmjetësit.

Neni 6

Marrëdhënia me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e tjera të etikës

1. Respektimi i Kodit të Etikës nuk paragjykon zbatimin e legjislacionit në fuqi ose dispozitave që rregullojnë profesionet individuale dhe plotëson legjislacionin në fuqi.
2. Dispozitat e këtij Kodi Etike, nuk cenojnë zbatimin e rregullave të tjera të etikës të zbatueshme ndaj subjektit, që ushtron njëherazi edhe veprimtarinë e ndërmjetësit dhe që i përket edhe kategorisë apo ushtrimit të një profesionit tjetër, të cilat parashikojnë dispozita dhe standardet etike më të larta dhe/ose më të detajuara.

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME TË NDERMJETËSIMIT

Neni 7

Bazat e ndërmjetësit

Veprimtaria e ndërmjetësit bazohet në parimin ligjshmërisë, të barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, në respektimin e fleksibilitetit e të transparencës së procedurave dhe të vullnetit të palëve në proces, duke garantuar në mënyrë objektive liritë, të drejtat, interesat e ligjshme të palëve.

Neni 8

Parimi i barazisë së palëve

1. Ndërmjetësi duhet të shmangë çdo paragjykim apo dallim në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, ndaj palëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësit.
2. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ndërmjetësi duhet të përkujdeset duke trajtuar në mënyrë të njëjtë situata të njëjta duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.
3. Ndërmjetësi duhet të kërkojë që personeli, stafi, bashkëpunëtorët e tij të shmangin paragjykimet apo njëanshmëritë dhe të veprojnë në përputhje me parimet e Kodit të Etikës.

Neni 9

Kushtet e ndërmjetësit

1. Në ushtrimin të veprimtarisë së ndërmjetësisimit, ndërmjetësi duhet të përpiqet që çështja të mund të zgjidhet me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri, si dhe në mënyrë profesionale e pa paragjykime ndaj palëve apo çështjes që përbën objektin e ndërmjetësisimit. Për arritjen e këtij qëllimi ndërmjetësi përdor të gjitha mjetet e ligjshme që ka në dispozicion.
2. Procesi i ndërmjetësisimit është vullnetar dhe palët në mosmarrëveshje janë të lira:
 - a) të zgjedhin ndërmjetësimin, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në këtë ligj;
 - b) të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme;
 - c) të heqin dorë, në çdo kohë, nga zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.
3. Në rastin kur palët arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet tyre, ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje ose nëse marrëveshja është arritur, por nuk zbatohet nga palët.
4. Ndërmjetësi gjatë procesit të ndërmjetësisimit, gjithmonë, duhet të nxisë integritetin dhe drejtësinë mes palëve. Ai është përgjegjës dhe duhet të respektojë rregullat dhe standardet të larta të sjelljes në mënyrë që vullneti i lirë, dinjiteti, integriteti dhe ndershmëria e procesit të ndërmjetësisimit të mos cenohen nga askush.
5. Gjatë kryerjes së funksionit, ndërmjetësi duhet të formulojë propozime për ndërmjetësim në pajtim me ligjin dhe rregullat e detyrueshme.

Neni 10

Rregulla të përgjithshme të sjelljes

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ndërmjetësi duhet:

1. të veprojë me përpikërinë dhe kujdesin profesional, sipas parimeve morale të ndershmërisë dhe besnikërisë bazuar në rregullat e profesionalizmit dhe kërkesave të arsyes;
2. të veprojë gjithmonë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në veçanti me atë që rregullon profesionin e tij duke i dëshmuar, për palën që e kërkon, faktin e regjistrimit dhe licencimit të tij;
3. të paraqesë informacion të saktë rreth edukimit të tij, profesionit, trajnimit si ndërmjetës dhe eksperiencën për palët në proces;
4. të zbatojë dhe t'i përmbahet në mënyrë rigoroze parimit të sekretit profesional dhe të kërkojë që ky parim të jetë respektuar edhe nga punonjësit, personeli, stafi, bashkëpunëtorët dhe asistentët, të cilët e ndihmojnë atë në kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësisimit në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë gjithë ndërmjetësisimit;
5. të jetë vazhdimisht i përditësuar në mënyrë që shërbimet e tij profesionale të ofruara të jenë cilësore, të kualifikuara dhe kompetente;

6. të veprjË gjithmonË me transparencË dhe integritet moral e profesional, duke shmangur çdo keqkuptim të mundshëm në interes të palëve dhe të krijimit të paragjytimeve mbi dinjitetin e profesionit të ndërmjetËsit;
7. të përmbahet nga zgjedhja e mënyrave të pandershme dhe mashtruese të reklamave për veprimtarinë e tij duke e paraqitur në mënyrën e duhur shërbimin e ofruar prej tij;
8. të mos pranojë dhurata apo përfitime ekonomike nga secila prej palëve;
9. të veprjË në përputhje me parimet e drejtësisë, bashkëpunimit dhe solidaritetit në marrëdhëniet me kolegët;
10. të kujdeset për përdorimin e një fjalori të qartë e të kuptueshëm me palët dhe personat e tretë.

Neni 11

Marrëdhëniet midis të ndërmjetësve

1. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ndërmjetËsit pjesëtar i personit juridik i ndalohe:

 - a) Të bashkëpunojë me personat që ushtrojnë në mënyrë abuzive profesionin e ndërmjetËsit;
 - b) Të ushtrojë veprimtarinë ndërmjetësuese drejtpërdrejtë me persona që kanë marrëdhënie varësie apo bashkëpunimi me palën apo me kolegë të tjerë, në qoftë se për një bashkëpunim të tillë pune nuk është rënë më parë dakord me titullarët e personave juridik përkatës;
 - c) Të përdorë mjete që mund të krijojnë keqkuptime dhe konfuzion me kolegët në tregun e ndërmjetësimi;
 - ç) Të kryejë akte të konkurrencës së pandershme;
 - d) Të garantojë zgjidhjen ose premtimin e rezultateve të caktuara të ndërmjetësimi.

2. Në rastin e pjesëmarrjes së më shumë se një ndërmjetËsi, ku zgjidhja i është besuar vetëm njërit, kryesimi për zgjidhjen përfundimtare të çështjes i takon ndërmjetËsit të cilit ajo i është caktuar;
3. Në rast arritjeje të një marrëveshje ndërmjetësimi të përmyllur nga disa ndërmjetës, mbi ndarjen shpërblimit duhet të jetë rënë paraprakisht dakord mes palëve, mundësisht me shkrim. Në mungesë të një marrëveshjeje, masa e shpërblimit do të ndahet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe praktikat e mira.
4. Në veçanti, ndërmjetËsi duhet të përmbahet nga përdorimi stemës apo i imazhit të dhomës, si dhe çdo tipari tjetër dallues që përcakton anëtarësinë e subjektit ndaj dhomës që synon të nxisë konkurrencën e pandershme kundrejt kolegëve.
5. NdërmjetËsi i licencuar është i detyruar të raportojë tek organet kompetente të Dhomës të gjitha format e konkurrencës së pandershme, reklamat mashtruese, përdorimin e papërshtatshëm të stemës apo imazhit të dhomës, si dhe çdo fakt tjetër

që mund të dëmtojë imazhin dhe profesioni e ndërmjetësit në ato raste ku ai është dëshmitar.

Neni 12

Marrëdhënia midis ndërmjetësit dhe klientit

1. Ndërmjetësi duhet të japë një vlerësim korrekt dhe të paanshëm të çështjes objekt ndërmjetësimi dhe, nëse është e nevojshme, të jetë në dispozicion që të ofrojë shërbimin e tij ndaj klientit deri në përfundim të marrëveshjes.
2. Ndërmjetësi duhet të përmbahet nga pranimi i çështjeve për ndërmjetësim, të cilat nuk mund t'i trajtojë me aftësinë e përshtatshme, në qoftë se ai nuk është në dijeni të rregullave/ligjeve/rregulloreve apo të parametrave vlerësuese për disa lloje të caktuara të produkteve, të tilla si ato komerciale, pasuri të paluajtshme, etj., përveçse kur vërteton se bashkëpunon me kolegë të tjerë dhe/ose me profesionistë apo ekspertë të fushës përkatëse.
3. Për çdo çështje ndërmjetësimi të marrë përsipër, mundësisht me shkrim, ndërmjetësi duhet bëjë përpjekje për të gjetur çdo dokument të nevojshëm dhe / ose të dobishëm për ushtrimin e duhur të veprimtarisë ndërmjetësuese.
4. Ndërmjetësi duhet të njoftojë klientin në lidhje me ndonjë vështirësi praktike që ka të bëjë me çështjen objekt ndërmjetësimi.

Neni 13

Bashkëpunimi i ndërmjetësit me Dhomën

1. Ndërmjetësi ka detyrimin për ofruar bashkëpunimin e përshtatshëm ndaj Dhomës së Kombëtare të ndërmjetësve dhe asaj të anëtarësisë me qëllim që Dhoma përkatëse të ushtrojë në mënyrë efektive funksionin rregullues dhe kontrollues të parashikuar nga ligji, duke synuar cilësinë e veprimtarisë, ruajtjen e prestigjit dhe të etikës së ndërmjetësit.
2. Ndërmjetësi me status aktiv ka detyrim për të marrë pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Ndërmjetësve dhe të respektojë vendimmarrjen e Dhomës së anëtarësisë dhe/ose të Dhomës Kombëtare të ndërmjetësve.

KREU III

OBJEKTIVITETI I NDËRMJETËSIT

Neni 14

Pavarësia

1. Në rast se ekzistojnë rrethana që mund (ose duket se mund) të çenojnë pavarësinë e ndërmjetësit ose të krijojnë një konflikt interesi, ndërmjetësi ka detyrimin për të njoftuar palët para se të veprojë apo të vazhdojë veprimtarinë e tij.
2. Rrethanat e sipërpërmendura, krahas atyre të parashikuara nga neni 13, përfshijnë:
 - a) Çdo lloj marrëdhënie personale apo profesionale me njërin prej palëve;
 - b) Çdo interes financiar ose tjetër, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ka të bëjë me rezultatin e procesit të ndërmjetësimit;
 - c) Faktin nëse ndërmjetësi ose një anëtar subjektit juridik ku bën pjesë ai, ka vepruar me ndonjë cilësi tjetër të ndryshme përveç asaj të ndërmjetësit për një ose më shumë palë.
3. Në raste të tilla, ndërmjetësi mund të pranojë detyrën ose të vazhdojë ndërmjetësimin vetëm nëse ai është i sigurt që mund ta kryejë ndërmjetësimin me pavarësi të plotë, duke garantuar paanshmëri të plotë dhe vetëm me pëlqimin e shprehur të palëve.
4. Informimi i palës lidhur me paraqitjen e këtyre rrethanave përbën një detyrim të ndërmjetësit, i cili vazhdon përgjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurave ndërmjetësuese.
5. Ndërmjetësi duhet të jetë i angazhuar ndaj palëve dhe procesit të ndërmjetësimit dhe të mos lejojë të kushtëzohet nga ndikime apo orientime prej personave të tretë, të cilët komprometojnë ose duket sikur komprometojnë pavarësinë e ndërmjetësit.

Neni 15 Paanshmëria

1. Ndërmjetësi duhet të pranojë të ofrojë shërbimin e tij në ndërmjetësim vetëm për ato çështje për të cilat ai është në gjendje të qëndrojë i paanshëm ndaj palëve.
2. Në procesin e ndërmjetësimit, në marrëdhëniet me palët, ndërmjetësi, në çdo kohë, duhet të veprojë në mënyrë të paanshme, dhe të bëjë përpjekje për t'u shfaqur si i tillë përpara tyre. Ndërmjetësi duhet të angazhohet për të ndihmuar në mënyrë të barabartë të gjitha palët pjesëmarrëse me ndershmëri.
3. Në qoftë se ndërmjetësi bëhet i vetëdijshëm për mungesën e paanshmërisë së tij, menjëherë ai duhet t'ua bëjë të ditur palëve këtë fakt.
4. Ndërmjetësi duhet të sillet në mënyrë të drejtë e të rregullt me të gjitha palët, dhe nuk duhet të kushtëzohet nga interesa vetjake apo të tretëve. Ai duhet të shmangë sjelljen dhe deklaratat që duken në përkrahje ose kundër të palëve në proces.
5. Ndërmjetësi që ka qenë ose është përfaqësues ligjor i palëve, gjyqtar në proces gjyqësor apo arbitër nuk mund jenë ndërmjetës në lidhje më të njëjtat palë.

Neni 16

Konflikti i interesave

1. Gjatë procesit të ndërmjetësimit, ndërmjetësi duhet të sigurohet që midis tij dhe palëve të mos ekzistojë asnjë konflikt interesash. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi duhet të heqë dorë nga procedurat e ndërmjetësimit.
2. Konsiderohet se ka konflikt interesash kur:
 - a) ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me palën apo të afërmit e saj, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;
 - b) ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve;
 - c) ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë, janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie, pune, ortakërie ose huaje me njërin prej palëve;
 - d) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.
3. Kur i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetës, ndërmjetësi duhet të deklarojë me shkrim, si dhe të vërë në dijeni palët për çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose të shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në lidhje me rastin që i paraqitet për ndërmjetësim.
4. Çdo çështje që lind përpara ose gjatë procedurës së ndërmjetësimit, e cila shkakton përfshirjen e ndërmjetësit në mënyrë personale apo në një konflikt interesi, të çdo lloji e natyre, duhet t'i bëhet e ditur palëve dhe Dhomës së anëtarësisë, Në këtë rast procedura duhet të ndërpritet, përveçse kur palët bien dakord me shkrim për këtë fakt dhe ndërmjetësi është në gjendje që ta administrojë rregullisht ndërmjetësimin.

KREU IV

PRIVATËSIA DHE KONFIDENCIALITETI NË NDËRMJETËSIM

Neni 17

Fshehtësia dhe sekretit profesional

1. Ndërmjetësi ka detyrimin për respektimin e privatësisë dhe sekretit profesional të gjitha informacioneve dhe komunikimeve të marra nga palët dhe ekspertët që i asistojnë ata gjatë procesit të ndërmjetësimit. Ai duhet të informojë palët rreth natyrës konfidenciale të ndërmjetësimit.
2. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbeten konfidenciale.

3. Në qoftë se ndërmjetësi mban takime të veçanta nga njëra palë, ai duhet të diskutojë mbi natyrën e takimeve të tilla me të gjitha palët përpara zhvillimit të takimeve. Ndërmjetësit duhet informojnë palët mbi ndonjë kufizim për zbatimin e konfidencialitetit lidhur me informacionin që zbulohet gjatë takimeve private. Ndërmjetësi duhet të ruajë sekretin profesional rreth çdo informacioni për të cilin ka marrë dijëni gjatë takimeve të veçanta me palët, në qoftë se në mënyrë specifike nuk lejohet t'ia bëjë të ditur këtë informacion palës tjetër. Ai duhet të respektojë sekretin profesional edhe gjatë disponimit të shënimeve dhe të dosjeve të procedurës së ndërmjetësimit.
4. Ndërmjetësi ruan konfidencialitetin për të dhënat, për të cilat ka dijëni për shkak të një procedure ndërmjetësimi, në raport me secilën prej palëve apo me persona të tjerë jashtë procedurave të ndërmjetësimit, me përjashtim të rastit kur pala, të dhënat e së cilës bëhen publike ose përpunohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka dhënë miratimin e saj me shkrim për këtë.

Neni 18

Ndalimi i zbulimit të të dhënave konfidenciale

1. Ndërmjetësi nuk duhet të zbulojë veçanërisht të dhënat e mëposhtme:
 - a) Faktin që procedura për ndërmjetësim është gati për të filluar apo do të fillojë, apo ka filluar;
 - b) Identitetin e palëve në çështjen e ndërmjetësimit;
 - c) Objektin e procedurës së ndërmjetësimit;
 - ç) Të gjitha informacionet e dhëna gojarisht apo me shkrim nga palët apo përfaqësuesit ligjor të tyre, si dhe të gjitha informacionet lidhur me procedurën e ndërmjetësimit;
 - d) Marrëveshjen përfundimtare, kushtet dhe termat e saj.
2. Çdo informacion i dhënë në mirëbesimin ndaj ndërmjetësit nga njëra prej palëve nuk duhet t'i zbulohet palës tjetër pa pëlqimin e palës, përvese kur kjo kërkohet me ligj.

Neni 19

Zbulimi i të dhënave konfidenciale

1. Ndërmjetësi nuk ka detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë nëse:
 - a) palët bien dakord me shkrim për përhapjen e të dhënave në masën dhe mënyrën e rënë dakord;
 - b) zbulimi i të dhënave kërkohet me ligj;
 - c) është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelore të shtetit dhe/apo interesit publik;

- ç) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara ose grave;
 - d) përdoren për raporte, përmbledhje dhe statistika që kërkohet të përgatitet nga ndërmjetësit, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve apo Ministria e Drejtësisë;
 - dh) kur informacioni nuk është i identifikueshëm dhe do të përdoret për qëllime të kërkimit statistikor ose qëllime edukimi dhe kufizohet vetëm në sa duhet për të arritur këto qëllime;
 - e) vihet në dijeni mbi rrethana, të cilat po të mbahen të fshehta, shkaktojnë një dëm për ruajtjen fizike, shëndetin, jetën apo sigurinë e palës apo personave të tretë, për të cilat mendon të konsultohet me organet e Dhomës së anëtarësisë.
 - ë) përbëjnë çështje të karakterit etik apo deontologjik;
 - f) nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i marrëveshjes.
2. Në çdo rast komunikimi duhet të mbetet konfidencial.

Neni 20 **Dëshmia e ndërmjetësit**

Ndërmjetësi ruan sekretin profesional dhe nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte dhe rrethana, për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit, përveç rasteve kur ka detyrimin me ligj për referimin e fakteve pranë autoriteteve përkatëse publike.

KREU V

LIRIA DHE VULLENTI I PALËS NË ZGJEDHJEN E NDËRMJETËSIMIT

Neni 21 **Respektimi i parimit të vullnetit të lirë**

1. Vetëvendosja është e drejta e palëve në një procedurë ndërmjetësimi, për të marrë vendimet e tyre në bazë të vullnetit të lirë dhe jo të detyruara për sa i përket zgjidhjes së mundshme të çështjeve në mosmarrëveshje dhe mënyrës së zhvillimit të ndërmjetësimit.
2. Ndërmjetësi duhet të respektojë dhe të inkurajojë zbatimin e këtij parimi në kërkim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe të përmbahet, gjatë procedurës nga kushtëzimi i vetëm njërës palë.

3. Parimi i vullnetit të lirë është themelor dhe i pashmangshëm, përveç rastit kur evidentohet si një përpjekje e qartë nga ana e palëve për të shkelur ligjin. Në këtë rast procedura duhet të ndalet menjëherë dhe ndërmjetësi duhet të informojë dhomën e anëtarësisë. Çdo palë mund të tërhiqet në çdo kohë nga procedura e ndërmjetësimit.
4. Përpara fillimit të procesit, ndërmjetësit duhet të japin shpjegime rreth rolit të tyre në ndërmjetësim duke përfshirë faktin që autoriteti i vetëm për marrjen e vendimeve i përket palëve dhe jo ndërmjetësit.
5. Ndërmjetësit nuk duhet të japin këshilla ligjore për palët për palët në proces.
6. Ndërmjetësit kanë përgjegjësinë të këshillojnë palët e pa përfaqësuar për të marrë përfaqësues ligjor të pavarur, ose ekspertizë nga profesionistë të tjerë të fushës së konfliktit, kur kjo është e përshtatshme dhe do të ndihmonte në arritjen e një zgjidhjeje.
7. Ndërmjetësi nuk ka detyrim për t'u pajtuar me procedura, rregulla dhe marrëveshje që janë në kundërshtim me ligjin dhe në kundërshtim me këtë Kod Etike.

KREU VI

AFTËSITË, ZGJEDHJA, SHPËRBLIMI I NDËRMJETËSIT DHE PROMOVIMI I SHËRBIMIT TË NDËRMJETËSIMIT

Neni 22

Kompetenca profesionale

1. Ndërmjetësi duhet të ketë aftësitë dhe njohuritë e duhura lidhur me procesin e ndërmjetësimit.
2. Njohuritë përkatëse duhet të përfshijnë trajnimin fillestar dhe përditësimin e vazhdueshëm, si dhe praktikat e tyre në aftësitë e ndërmjetësimit, duke pasur parasysh standardet përkatëse dhe sistemet e aksesit në profesion.
3. Ndërmjetësi ka për detyrë të sigurojë që do të zhvillojë një proces, i cili u jep palëve mundësinë të marrin pjesë në ndërmjetësim dhe që inkurajon respektin e ndërsjelltë midis tyre.

Neni 23

Shpërblimi i ndërmjetësit

Në rast se nuk është e parashikuar në kontratën për pranimin e çështjes, ndërmjetësi gjithmonë duhet të t'u japë palëve informacion të plotë mbi mënyrën e shpërblimit që synon të zbatojë për punën e ndërmjetësit dhe shpenzimet e

kryera. Ndërmjetësi nuk duhet të pranojë një çështje ndërmjetësimi, në rast se parimet e shpërblimit të tij nuk janë miratuar ende nga të gjitha palët e interesuara.

Neni 24

Promovimi i shërbimeve të ndërmjetësimit

Ndërmjetësi mund të promovojë veprimtarinë e tij tregtare si ndërmjetës, me kusht që kjo të bëhet në mënyrë profesionale, konform realitetit dhe në mënyrë të denjë.

Neni 25

Edukimi i publikut

Ndërmjetësi duhet të përpiqet të perfeksionojë praktikën e ndërmjetësimit dhe të përdorë njohuritë e tij për të ndihmuar në edukimin e publikut rreth ndërmjetësimit dhe pajtimit.

Neni 26

Marrëdhëniet midis ndërmjetësve

Marrëdhëniet ndërmjet ndërmjetësve duhet të karakterizohen nga respekti reciprok. Ata punojnë me një shpirt bashkëpunimi gjatë kryerjes të aktiviteteve të tyre dhe kontribuojnë për krijimin e një fryme pune miqësore dhe të zellshme, në zyrën dhe ambientet ku ata punojnë.

Neni 27

Tarifa

1. Ndërmjetësi paguhet për shërbimin e tij. Ai mund të tërhiqet nga ndërmjetësimi në rast se palët refuzojnë ose dështojnë të paguajnë shërbimin bazuar në marrëveshjen paraprake.
2. Mbi shpenzimet e kryera si rezultat i veprimtarisë së ndërmjetësimit, ndërmjetësi duhet t'i përmbahet parimit të ndershmërisë, gjatë kompensimit të shpenzimeve të procesit të ndërmjetësimit.

KREUVII

PROCESI I NDËRMJETËSIMIT

Neni 28

Caktimi i ndërmjetësit

1. NËrmdjetËsi zgjidhet bashkarisht nga palËt.
2. Para pranimit tË çshtjes objekt ndËrmdjetËsimi, ndËrmdjetËsi duhet tË marrË masat nË mËnyrË qË ai tË ketË aftËsitË dhe kompetencËn e nevojshme pËr tË kryer ndËrmdjetËsimin e rastit tË paraqitur, dhe sipas kËrkesËs sË palËs, duhet tË japË informacion lidhur me pËrgatitjen e pËrshtatshme tË tij.
3. NËrmdjetËsit duhet tË konsultohet me palËt lidhur me datat e pËrshtatshme nË tË cilat mund tË zhvillohet ndËrmdjetËsimi.

Neni 29

MarrËveshja paraprake pËr ndËrmdjetËsim

1. PËrpara fillimit tË procedurËs sË ndËrmdjetËsimit, ndËrmdjetËsi ËshtË i detyruar qË tË informojË palËt pËr qËllimet dhe parimet e pËrgjithshme, rolin e ndËrmdjetËsit dhe tË palËve nË proces, shpenzimet e procesit tË ndËrmdjetËsimit dhe efektet e marrËveshjes pËr realizimin e procesit tË ndËrmdjetËsimit.
2. NËrmdjetËsi, nË veçanti, duhet tË sigurohet se pËrpara tË fillimit tË ndËrmdjetËsimit, palËt tË kenË kuptuar dhe pranuar shprehimisht termat dhe kushtet e ndËrmdjetËsimit, duke pËrfshirË edhe dispozitat ligjore nË fuqi lidhur me detyrimet e konfidencialitetit pËr ndËrmdjetËsin dhe palËt pjesëmarrËse. Kur ËshtË e mundur, ndËrmdjetËsi duhet tË parashikojË nËj marrËveshje/kontratË paraprake me shkrim pËr ndËrmdjetËsimin, termat e sË cilËs pËrfshijnË, por jo vetËm, çshtjet e mËposhtme:
 - a) gjenealitetet e palËve tË kËsaj marrËveshjeje dhe tË pËrfaqËsuesve tË tyre;
 - b) pËrshkrimin e objektit tË mosmarrËveshjes;
 - c) pranimin e termave dhe kushteve tË ndËrmdjetËsimit, sipas kËtij ligji dhe tË ndËrmdjetËsit tË caktuar;
 - ç) vendin e ndËrmdjetËsimit;
 - d) konfidencialitetin e komunikimeve dhe dokumenteve;
 - dh) TË drejtËn e NËrmdjetËsit dhe palËve pËr tË pËrfunduar ose ndËrprerË ndËrmdjetËsimin;
 - e) Tarifat, shpenzimet, metodËn e pagesËs dhe tipin e tarifËs nË qoftË se ka, pËr moszhvillimin, ndËrprerjen ose vonesat; dhe
 - Ë) Faktin qË ndËrmdjetËsi nuk mund tË thirret me forcË si dËshmitar nË nËj procedim gjyqËsor nga ndonjËra nga palËt nË ndËrmdjetËsim.
 - f) shpenzimet e ndËrmdjetËsimit dhe shpËrblimin e ndËrmdjetËsit.
3. NË mungesË tË nËj marrËveshjeje pËr mËnyrËn e zhvillimit tË ndËrmdjetËsimit, ndËrmdjetËsit mund ta zhvillojnË ndËrmdjetËsimin nË mËnyrËn mË tË pËrshtatshme pËr palËt, mbËshtetur nË rrethanat e çshtjes, nË çdo kËrkesË qË mund tË paraqesin palËt dhe nË çdo nevojË pËr nËj zgjidhje tË shpejtË tË mosmarrËveshjes.

Kur është bërë marrëveshje, ndërmjetësi është i detyruar të arkivojë për një afat kohor prej 5 vjetësh, dosjen origjinale të gjitha dokumenteve të përdorura në procesin e ndërmjetësimit dhe proceset verbale.

Neni 30 Procedura

1. Ndërmjetësi duhet të sigurohet që palët në ndërmjetësim të kenë kuptuar natyrën e procesit të ndërmjetësimit, rolin e ndërmjetësit dhe rolin e secilës palë dhe të përfaqësuesit të tyre. Ndërmjetësi duhet të informojë palët në një mosmarrëveshje që ndërmjetësimi është më dobiprurës kur palët me autoritet të plotë për të vendosur janë të pranishme dhe kur ato janë të gatshme të marrin në konsideratë mundësitë e zgjidhjes.
2. Ndërmjetësi duhet të bindet vetë që secila palë e përfshirë në proces të marrë pjesë me vullnetin e saj të lirë dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Në rast të kundërt ndërmjetësi duhet të pezullojë menjëherë procedurën.
3. Ndërmjetësi administron procedurën në përputhje me parimet e konfidencialitetit, vullnetit të lirë, arsyes së shëndoshë dhe atë të shpejtësisë.
4. Kur kërkesa për ndërmjetësim është formuluar nga gjykata, ndërmjetësi së pari duhet të sigurohet, me diskrecion dhe maturi, nëse palët dëshirojnë të ushtrojnë këtë alternativë dhe kanë kuptuar natyrën dhe qëllimin e saj.
5. Para se të fillojë procedura, ndërmjetësi duhet të marrë dijeni të dokumenteve të ofruara nga palët, në mënyrë që të përgatitet në mënyrë të përshtatshme mbi objektin e mosmarrëveshjes. Me kërkesën e palëve, termat e fakteve të mosmarrëveshjes objekt ndërmjetësimi mund të bëhen në formë të shkruar.
6. Ndërmjetësi duhet të zhvillojë procedurën e ndërmjetësimit në një mënyrë të përshtatshme, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, duke përfshirë edhe pabarazitë e mundshme në marrëdhëniet e forta, dëshirat e mundshme të shprehura prej palëve, dispozitat ligjore të veçanta, si dhe nevojën për një zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjes.
7. Palët mund të bien dakord me ndërmjetësin lidhur me mënyrën sipas të cilës duhet të zhvillohet ndërmjetësimi, duke iu referuar një sërë rregullave të rakorduara apo tjetër mënyre më parë prej tyre dhe ndërmjetësit.
8. Nëse ndërmjetësi e gjykon të përshtatshme, ai mund të dëgjojë palët veçmas. Ndërmjetësi, në cilësinë e tij si person i tretë dhe asnjans, duhet të ndihmojë palët për të gjetur zgjidhjen për konfliktin, duke lehtësuar komunikimin, promovuar mirëkuptimin e ndërsjelltë, si dhe duke asistuar në identifikimin e interesave të përbashkëta të mundshme ndërmjet palëve.

Neni 31 Rregullsia e procesit

1. Ndërmjetësi duhet të garantojë që të gjitha palët mund të ndërhyjnë në mënyrë të përshtatshme në procesin ndërmjetësues.
2. Ndërmjetësi duhet të informojë palët dhe mund të përfundojë ndërmjetësimin, në rast se:
 - a) Ka arritur një marrëveshje që ndërmjetësit i duket e pazbatueshme apo e paligjshme, duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe kompetencën e ndërmjetësit për të arritur këtë vlerësim, ose kur
 - b) Ndërmjetësi konstaton se vazhdimi i ndërmjetësimit nuk ka gjasa të rezultojë në arritjen e një zgjidhjeje të mosmarrëveshjes.
3. Ndërmjetësi mund të caktojë ekspertë të zgjedhur nga radhët e listave të eksperteve të gjykatës dhe duhet të jetë i paanshëm në përzgjedhjen e tyre.

Neni 32

Përfundimi ose pezullimi i ndërmjetësimit

1. Procedura e ndërmjetësimit përfundon në rastet e parashikuara nga neni 21 i Ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.
2. Përveç rasteve të referuara nga pika 1 e këtij neni, ndërmjetësi pezullon procedurën e ndërmjetësimit në qoftë se:
 - a) procesi mund të paragjykohet nga një ose më shumë palë;
 - b) një ose më shumë nga palët po e përdorin procesin në mënyrë të papërshtatshme;
 - c) një ose më shumë nga palët po e vonojnë procesin në dëm të palës ose palëve të tjera;
 - ç) procesi i ndërmjetësimit është në dëm të një ose më shumë palëve ose ndërmjetësit;
 - d) duket që një palë nuk po vepron në mirëbesim; ose
 - dh) lindin shkaqe të tjera që janë ose duken joproduktive për procesin.
3. Ndërmjetësi duhet të përfundojë ndërmjetësimin në qoftë se rrethanat e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni nuk shmangen.
4. Ndërmjetësi duhet të tërhiqet nga ndërmjetësimi për shkaqe që lidhen me cenimin e pavarësisë, paanshmërisë, të konfliktit të interesave dhe të mospagimit të tarifave, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ky Kod.
5. Kur ndërmjetësi tërhiqet para përfundimit të procesit të ndërmjetësimit, qoftë me nismën tij ose të ndonjërit prej palëve në proces, ai duhet të ndërmarrë hapat e arsyeshme për të mbrojtur interesat e palëve në ndërmjetësim, duke përfshirë kthimin e materialeve dhe provave origjinale dhe të ruaj kofidencialitetin e të dhënave.

Neni 33

Tërheqja e ndërmjetësit

1. Ndërmjetësi duhet të tërhiqet nga çështja nëse:
 - a) Një ose më shumë prej palëve paraqet kërkesë të arsyetuar;
 - b) Të gjitha palët bëjnë një kërkesë të përbashkët;
 - c) Nuk vepron në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Kod;
 - ç) Procedura mund përdoret për arritjen e marrëveshjeve të paligjshme;
 - d) krijohet shkaqe paaftësia e tij fizike ose mendore;
 - dh) lindin shkaqe papajtueshmërie dhe / ose konfliktit të interesit me një ose më shumë prej palëve.
2. Ndërmjetësi mund të tërhiqet nga detyra, nëse konstaton se:
 - a) Një apo më shumë palë janë duke shfrytëzuar procedurën;
 - b) Njëra nga palët vepron me qëllim zvarritjen apo pengimin e procesit ose në mënyrë të paligjshme.

KREU VIII ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES

Neni 34 Fundi i procesit të ndërmjetësimit

1. Ndërmjetësi duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që çdo marrëveshje e midis palëve të arrihet bazuar në pëlqimin e tyre dhe që të gjitha palët të kuptojnë kushtet e zgjidhjes së arritur.
2. Palët mund të tërhiqen nga ndërmjetësimi në çdo kohë pa dhënë ndonjë arsye.
3. Ndërmjetësi, me kërkesë të palëve dhe brenda kufijve të kompetencës së tij, duhet të informojë palët lidhur me mënyrat me të cilat ato mund të formalizojnë marrëveshjen dhe mundësinë e bërjes së marrëveshjes të ekzekutueshme.

Neni 35 Njoftimi i autoriteteve publike kompetente

Me përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton me shkrim, brenda afateve të përcaktuara në ligj gjykatën ose arbitrazhin, me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.

KREU IX SHKELJET E KODIT TË ETIKËS

Neni 36

Masat disiplinore për shkelje të rënda

1. Konsideron si shkelje të rënda të Kodit të Etikës, shkelja e dispozitave të parashikuara në Kreun II të tij, si dhe rastet kur ndërmjetësi brenda një periudhe 3 (tre) vjeçare, nga data e kryerje së shkeljes së parë, kryhen disa herë një shkelje jo të rëndë, ose kryhen disa shkelje jo të rënda njëherazi gjatë kësaj periudhe. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, në cilësinë e të tretit, mund të kërkojë përmes ankimit heqjen e licencës së ndërmjetësit kur vihet në dijeni të shkeljeve të rënda të Kodit të Etikës dhe të shkeljeve të tjera ligjore.
2. Me heqjen e licencës, ndërmjetësi çregjistrohet nga regjistri i ndërmjetësve sipas procedurës të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 08.06.2011 “Për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit”.

Neni 37

Masat disiplinore për shkelje jo të rënda

1. Ndërmjetësit, i cili nuk vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Etikës, apo kryen shkelje të Kodit të Etikës ose ligjore që nuk konsiderohen si të rënda, mund t’i hiqet çështja objekt gjykimi nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve me vendim të veçantë të arsyetuar.
2. Ndërmjetësi, i cili nuk vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Etikës, apo kryen shkelje që nuk konsiderohen si të rënda në mënyrë të përsëritur paralajmërohet me vendim të dhomës së anëtarësisë ose të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve kur ka të dhëna që provojnë shkeljet e kryera në mënyrë të përsëritur brenda një periudhe 3 (tre) vjeçare, nga data e kryerje së shkeljes së parë.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38

Publiciteti

1. Kodi i Etikës publikohet dhe botohet në të gjitha format e parashikuara për njoftimin e akteve.
2. Kopje e këtij Kodi qëndron në dispozicion të publikut në dhomat vendore dhe një kopje publikohet në faqen zyrtare të internetit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me vendimin nr. 11 datë 27, 12, 2013 në Mbledhjen e Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve

Referenca:

1. Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (98)1 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet familjare, Strasburg, 21 janar 1998.
2. Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R(99)19 Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale, Strasburg, 15 shtator 1999.
3. Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R(2002)10 drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet civile, Strasburg, 18 shtator 2002.
4. Direktiva 2008/52/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit mbi aspekte të caktuara të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare, 21 maj 2008, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:136:0003:0008:En:PDF>
5. Ligji Model i UNICITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare) për Pajtimin në Çështjet Tregtare Ndërkombëtare, 2002.
6. The Code of Ethics for Arbitrators in Commercial Disputes Effective March 1, 2004 / American Arbitration and Association.
7. Kodi i Mirësjelljes së Ndërmjetësve në Republikën e Kosovës
8. Kodi i Sjelljes së Ndërmjetësve / MEDART
9. Kodi i Etikës/ IEKA
10. Kodi Europian i Etikës
11. Shkresa MD (Drejtorja e Kodifikimit) Mbi disa sugjerime , Tetor 2013